



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:185374

Datë: 16.12.2023

Numri i dokumentit: 05078124

P.nr. 336/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Leon Përlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qendresa Sadrijaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit L. G. , për shkak të veprës penale “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, nga neni 356 par.9 lidhur par. 6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1375/20 të dt.27.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 05.12.2023, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorian Juniku, të akuzuarit L. G. , mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Budak Shala dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar Sh. K. , Gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.12.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L. G. , i lindur me datë ....., në Pejë, me vendbanim në Pejë, Rr. “H. R.”, nr. 13, nga i ati E. dhe nëna L. e gjinisë B., i martuar, baba i tre fëmijëve, punon si shofer kamioni, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të numrit personal ..... të lëshuar nga MPB- Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 12.07.2020 rreth orës 14:30, në fsh. H., K. Pejë, nga pakujdesia shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve, i cili rezulton me vdekjen e te ndjerit M. M., në atë mënyrë që, në ditën kritike gjersa i pandehuri ishte duke punuar në pronën e viktimës, si pasojë e shkuljes së brendit me ekskavator, brendhi bie mbi viktimën, i cili ka mbetur i vdekur në vendin e ngjarjes, ku vdekja e të njëjtit konstatohet në orën 14:36 min. nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë,

- me çka ka kryer veprë penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8, 9, 10, 23, 40 par. 1 nënpar.1.2, 46 par.1 nën par 1.1 lidhur me par. 2 nën par. 2.2, 47, 48, 49, 69, 70, 356 par. 9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, nenit 364, 365, 366 të KPPRK-së, i shqipton:

#### DENIM ME KUSHT

Ashtu që:

- I.** Të akuzuarit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës prej dy (2) vitesh, nuk kryen veprë të re penale- pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II.** Nëse i akuzuari gjatë periudhës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat shqiptohet dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet, gjykata e revokon dënimin me kusht.
- III.** I akuzuari obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor në shumen prej 20 (njëzetë) euro, si dhe taksës për kompensimin e viktimave të krimit, në shumë prej 20 (njëzet) euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV.** Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit, Sh. K. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko- civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit Aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.1375/20 të dt.27.04.2022, kundër të akuzuarit L. G. , për shkak të veprës penale “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, nga neni 356 par.9 lidhur par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.10.2022, në të cilën seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë por nga gjykata është refuzuar pranimi i fajësisë dhe është udhëzuar pala për të drejtën e paraqitjes së kundërshtimit të aktakuzës dhe provave në të.

Me datë 05.12.2023, është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorian Juniku, të akuzuarit L. G. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Budak Shala si dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar Sh. K. , në të cilën seancë i akuzuari përsëri ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata mori mendimin e palëve lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të gjitha palët u pajtuan me pranimin e fajësisë.

Gjykata konsideron se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, është në harmoni edhe me provat e propozuara e të bashkëngjitura në Aktakuzë siç janë: raporti i policit H. K., i dt.12.07.2020; raporti i policit K. K., i dt. 12.07.2020; raporti i policit H. M. i dt. 12.07.2020; raporti mbi vendin e ngjarjes V. K. dt.12.07.2020; raporti i policit Z. B. dt. 13.07.2020, dhe 14.07.2020; deklaratat e dëshmitarit A. C. dt.12.07.2020; deklaratat e dëshmitarit A. C. dt. 15.07.2020; deklaratat e të dyshuarit L. G. , dt. 13.07.2020; raporti i vendit të ngjarjes si dhe fotot e vendit të ngjarjes, raporti nr. 1130 dt. 20.07.2020, nga inspektori i punës A. K., raporti i autopsisë i dt.19.04.2022, si dhe shkresat tjera të lëndës, andaj konform nenit 322 e lidhur me nenin 242 par.2 dhe par. 6 të KPPRK-së, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Meqenëse, i akuzuari ka pranuar fajësinë gjykata, ka ftuar palët të japin fjalën e tyre përfundimtare respektivisht të paraqesin mendimet dhe argumentet në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Prokuror i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: Meqenëse këtu i akuzuari L. G.e pranoj fajësinë konform kushteve ligjore të përcaktuara me dispozitën ligjore të nenit 242 të

KPRK-së, nga se pranimin e fajësisë e bëri vullnetarisht, pa ndikim dhe në përputhje me të gjitha faktet në të cilat mbështet kjo aktakuzë, andaj nga Gjykata kërkoj që të akuzuarin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të proceduarës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese, ndërsa në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 70 par.2 pika 2.8 të Kodit Penal të R. Kosovës si rrethanë rënduese të vlerësoj pasojën fatale respektivisht vdekjen e tani të ndjerit M. M..

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: Nuk kam çka të shtoj tjetër përpos atyre që i thash më lartë, unë siç e thash edhe më lartë për të na lehtësuar edhe neve kërkoj që L. ti shqiptohet një dënim sa më i lehtë i mundshëm e që mundë të jetë me dënim me kusht.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: Në këtë çështje kemi pranim të fajësisë po thuaja në të gjitha fazat, kërkojmë nga Gjykata që gjatë marrjes së vendimit për lloji dhe lartësinë e dënimit fillimisht të merr për bazë dispozitën e nenit 74 të KPRK-së, si baza të posaçme për lirimin nga dënimi veprës penale të kryera nga pakujdesia, me qenë se këtu i pandehuri dhe viktimi, po ashtu dhe familja e tij kishin raporte të mira shoqërore gjë që vërtetohet edhe me deklarin e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, e që edhe faktikisht këtu i pandehuri nga momenti i këtij aksidenti ka përjetuar tronditje shpirtërore të cilën e ka edhe sot andaj ne si mbrojtje pretendojmë se në këtë çështje është i panevojshëm dënimi e qenë se ndaj të njëjtit veç është përjetuar në aspektin shpirtëror.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: E përkrah deklarin e avokatit dhe e falënderoj shumë përfaqësuesin e palës së dëmtuar.

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 7, 8, 9, 10, 23, 40 par. 1 nënpar.1.2, 46 par.1 nën par 1.1 lidhur me par. 2 nën par. 2.2, 47, 48, 49, 69, 70, 356 par. 9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, nenit 364, 365, 366 të KPPRK-së dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të akuzuarin nuk kemi fare rrethana rënduese që parashihen në nenin 70 par.2, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe

gjyqësor po ashtu, keqardhjen që ka shfaqur me rastin e pranimit të fajësisë duke e reflektuar dhe vërtetuar edhe bindjen e siç përshkruhet në dispozitivin e Aktgjykimit se në veprimet e të njëjtit nuk ka ekzistuar dashja dhe se vepra është kryer nga pakujdesia, faktin se edhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar i ka deklaruar gjykatës se ja kanë falur të akuzuarit pasi janë në dijeni se nuk ka ndodhur me qëllim dhe ka kërkuar dënim më të lehtë për të akuzuarin andaj duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 e 49 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të akuzuarit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari ligjvënësi ka paraparë që për këtë veprë penale të shqiptohet dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, e në këtë rast gjykata pas analizimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave ka vendosur që të akuzuarit t' i shqiptojë dënim me burg të kushtëzuar prej një (1) viti nëse brenda periudhës kohore të verifikimit prej dy (2) vitesh nuk kryen veprë tjetër penale. Përkitazi me këtë dënim të shqiptuar gjykata u bazua në nenin 49 par.1 në lidhje me kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht, ku parashihet që dënimi me kusht shqiptohet për vepra penale të dënueshme deri në pesë (5) vjet, përderisa kushti apo periudha e verifikimit prej dy (2) vitesh i është llogaritur ashtu siç parashihet me nenin 48 par.2 të KPRK-së, ku thuhet se: “... *koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vite*”.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të akuzuarit L. G. , është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 në par. 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendim për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, komfor nënitet 39 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të krimit.

Konform nënitet 463 par.1 dhe 2 KPPRK-së, përfaqësuesja ligjore të dëmtuarve për realizmin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**

P.nr.336/22, me datë 15.12.2023

Bashkëpunëtore profesionale  
Qendresa Sadrijaj

Gj y q t a r i  
Leon Përlaska

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.